

## “STATUT”

### I SHOQËRISE TREGTARE

### “MEDIA INTELLIGENCE” SHPK



#### Neni 1 Themelimi

Sot me datë 13.04.2020 ne themeluesit:

- **Z. Ardian Mullahi**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 30/01/1966, banues në Rolling Hills, V24, Lunder, Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. BA5808404.
- **Z. Auron Pashaj**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 04/10/1972, banues në Rr: Prokop Mima; Nd. 9, H 8, Ap.19; Njësia Bashkiake Nr. 5; Kodi postar 1019, Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. BC0964150.

kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

1.2 Emri i shoqërisë është MEDIA INTELLIGENCE sh.p.k.

1.3 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit të saj, Statutin dhe Aktin e Themelimit.

1.4 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër me vendimin e ortakëve.

#### Neni 2 Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarisë i shoqërisë MEDIA INTELLIGENCE Sh.p.k., do të jetë:

- Monitorim i përgjithshem i të gjitha llojeve të kanaleve mediatike (TV, Radio, Gazeta, Web, OOH, Rrjete Sociale, etj), monitorim përmbajtjeje mediatike, monitorim reklamash dhe fushatash promovionale, matje dhe analize e të dhënave mediatike, inteligjencë mediatike për pozicionim dhe fushata promovionale, verifikime fushatash promovionale, pasqyra lajmesh në media, njoftime te castit mbi lajme te publikuara, studime cilësore dhe sasiore mbi mediat, matje ndikimi të fushatave marketing dhe e marrëdhënieve me publikun në media, sisteme/teknologji dhe platforma informacioni për monitorim mediash.
- Monitorimi dhe krahasimi i ekspozimit mediatik të brandeve, produkteve apo shërbimeve. Analiza e reputacionit dhe performancës mediatike të brandeve, produkteve apo shërbimeve dhe krahasimi me atë të konkurrencës.
- Mbulim dhe analize gjithëpërfshirëse të lajmeve, politikës, çështjeve publike, biznesit dhe ekonomisë, të pasqyruara ne median e shkruar, audiovizive dhe ne mediat sociale.
- Monitorimi dhe auditimi i të drejtave të autorit ne median e shkruar, audiovizive, mediat sociale, ne koncerte, aktivitete massive, promociione etj.

#### Neni 3 Kohëzgjatja

3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin tregtar, në kohë të pakufizuar.

#### **Neni 4 Selia**

4.1 Selia e Shoqërise do të jetë Selia e Shoqërise do të jetë Rr. Rruga «Xhorxh Bush», P.2, Sh.3, Ap.34/1, Tirane, Shqiperi.

4.2 Shoqeria ka te drejtë të hape përfaqesi apo filial kudo brenda dhe jashte R.SH.

4.3 Selia mund të transferohet në cdo rreth tjetër me vendimin e Asamblesë se ortakëve.

#### **Neni 5 Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërise është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

5.2 Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte si me poshte:

**Ortaku themelues** - Ardian Mullahi: Zotërues i 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 65 000 lekë që përbën 65% të kapitalit themeltar të shoqërisë

**Ortaku themelues** - Auron Pashaj: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë te përgjithshme 35 000 lekë që përbën 35% të kapitalit themeltar të shoqërisë

#### **Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.


6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7 Transferimi i kapitalit**

7.1 Kuotat e kapitali të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

7.2 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.



7.3 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

## Neni 8

### Organet Vendimarrëse dhe Drejtuese

8.1 Asambleja e Ortakëve është organi me i lartë vendimarrës i shoqërisë.

8.2 Asambleja merr vendime me një ose disa ortakë që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar me përrjashtim të rasteve të mëposhtme ku kërkohet përfaqësim i te paktën 70% të pjesëve të kapitalit themeltar:

- a) ndryshimet e statutit;
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontrabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat b dhe c të kësaj pike;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera;
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;

8.3 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të nje autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

8.4 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

8.6 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.

## Neni 9

### Administrimi

9.1 Administratori i shoqërisë është Z. **Ardian Mullahi**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 30/01/1966, banues në Rolling Hills, V24, Lunder, Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. BA5808404 / numri personal G60130115L

9.2 Afati i emërimit është për një periudhe 1-vjecare, me të drejtë ripërtëritjeje.

9.3 Administratori i një shoqërie tregtare mëmë nuk mund të emerohet si administrator i një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.

## Neni 10

### Kompetencat e Administratorit

10.1 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politika tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatit dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe sëbashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesi këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

c) në cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

**Neni 15**  
**Likuidimi i shoqërisë**

- 15.1 Në rastin e prishjes, shoqëria i nënshtrohet likuidimit.
- 15.2 Për likuidimin e shoqërisë zbatohen rregullat e përcaktuara në Ligjin “Për shoqëritë tregtare”.
- 15.3 Asambleja e ortakëve të shoqërisë cakton likuidatorët duke përcaktuar edhe tagrat që ata kane.

**Neni 16**  
**Marrëdhëniet me të punësuarit**

- 16.1 Marrëdhëniet e shoqërisë me sindikatat rregullohen sipas Legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.
- 16.2 Për të punësuarit do të zbatohen dispozitat ligjore që formojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë si dhe kontratat individuale të punës.

**Neni 17**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**


- 17.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti si dhe cdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, nëqoftëse nuk zgjidhen me mirëkuptim, do të zgjidhen në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

**Neni 18**  
**Dispozitat perfundimtare**

- 18.1 Për gjithshka që nuk është paraqitur në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil dhe të Legjislacionit “Për shoqëritë tregtare”


**Ortaku**

**Auron Pashaj**



**Ortaku**

**Ardian Mullahi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER GENTIANA XH. SHKODRA

DATE 13/04/2020  
NR REP 796



V2020051750038277219



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 13.04.2020, para meje Notere GENTIANA XH. SHKODRA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën TIRANE, NR.2, ABDI TOPTANI, TORRE DRIN, NR.32, u paraqiten personalisht:

**NËNSHKRUES/IT:**

Z. Auron PASHAJ, atësia Myslim, amësia Leonora, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, Tiranë dhe banues në TIRANE, me adresë I. Tomini, lindur më 04/10/1972, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 027541067 dhe nr. personal H21004089V,

**NËNSHKRUES/IT:**

Z. Ardian MULLAHI, atësia Bardhyl, amësia Leman, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në TIRANE, me adresë 1003 Njesia bashkiake nr. 2 M.Grameno 9 2 21, lindur më 30/01/1966, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031173035 dhe nr. personal G60130115L

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Statutin e Shoqerise MEDIA INTELLIGENCE SHIP".

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

*Gentiana Xh. Shkodra*  
NOTER

